



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

**SHPLLJE PËR NJË VEND TË LIRE PUNE,
LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË**

**“Përgjegjës i Sektorit të Komunikimit” në Drejtorinë e
Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit Kategoria e
pagës III-a**

Në zbatim të nenit 25 dhe të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me të fundit nr. 748, date 19.12. 2018, Autoriteti i Konkurrencës shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për pozicionin:

- “Përgjegjës i Sektorit të Komunikimit” në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit;
- Kategoria e pagës III-a.

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë)
aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e dokumenteve:

21 shtator 2021

***Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.**



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
A U T O R I T E T I I K O N K U R R E N C Ë S
D R E J T O R I A E B U R I M E V E N J E R Ë Z O R E , B U X H E T I T D H E K O M U N I K I M I T

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin e mësipërm është:

Krijimi i standardit të duhur për organizimin e konferencave ose deklaratave për shtyp;

Të njihet me shtypin e ditës dhe në çdo rast të vlerësuar si kufizime të konkurrencës ia raporton eprorit nëpërmjet informacionit përkatës;

Mbajtja e lidhjeve të vazhdueshme me gazetarët e mediave të ndryshme, duke realizuar e shpërndarë njoftimet për shtyp;

Bashkëpunimi me projekte e KE, TAIEK apo çdo organizëm tjetër, si dhe me drejtoritë përkatëse për sigurimin e mbarëvajtjes së të gjithë aktiviteteve ndërkombëtare të realizuara brenda e jashtë vendit, në kuadër strategjish, plane pune etj.;

Të administrojë bazën e të dhënave për aktet e institucioneve ndërkombëtare, vizita studimore dhe përfaqësime jashtë vendit;

Të përgatitë informacione për eprorët në shkallë hierarkie rast pas rasti përpara apo pas organizimeve/pjesëmarrjeve lidhur me përfaqësime të AK-së në veprimtarinë kombëtare e ndërkombëtare.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria III-a);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt).

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë të nivelit “Master Shkencor”;
- b) Të zotërojnë njohuri shumë të mira profesionale, në fushën e komunikimit;
- c) Të zotërojnë aftësi për të përcaktuar objektiva dhe prioritete;
- d) Avantazh do të përbëjnë dhe studime apo diploma të tjera pasuniversitare në këtë fushë, vecanerisht në fushën e politikave dhe legjislacionit të BE-së;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

- e) Të kenë eksperiencë pune në Administratën Publike jo më pak se 2 vjet, në nivelin e ulët drejtues;
- f) Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi;
- g) Të zotërojnë gjuhën angleze dhe çdo gjuhë e dytë e vendeve të BE përbën avantazh.

2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

- b) fotokopje të diplomës;

- c) fotokopje të librezës;

- d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 21 shtator 2021

3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën **22 shtator 2021**, njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

- a) Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar;
- b) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c) Konkurrimi do të bazohet dhe në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, Politika Kombëtare e Konkurrencës, Kodin e Procedurave Administrative;
- d) *Për më shumë: www.caa.gov.al.*

5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta>

6.- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti i Konkurrencës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AK. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II- Ngritja në detyrë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 26 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësit civil", i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e vecanta si vijon:

- a) Të zotërojë diplomë të arsimit të lartë të nivelit "Master Shkencor";
- b) Të zotërojë njohuri shumë të mira profesionale, në fushën e komunikimit;
- c) Të zotërojë aftësi për të përcaktuar objektiva dhe prioritete;
- d) Avantazh do të përbëjnë dhe studime apo diploma të tjera pasuniversitare në këtë fushë, vecanerisht në fushën e politikave dhe legjislacionit të BE-së;
- e) Të kenë eksperiencë pune në Administratën Publike jo më pak se 2 vjet;
- f) Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi;
- g) Të zotërojë gjuhën angleze dhe çdo gjuhë e dytë e vendeve të BE përbën avantazh.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

- b) fotokopje të diplomës dhe listës se notave;
- c) fotokopje të librezës se punës;
- d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e) Vërtetimi i gjendjes gjyqësore;
- f) Numër kontakti dhe adresë vendbanimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentet e cituara më sipër me poste ose dorazi, **brenda datës 21 shtator 2021** në Autoritetin e Konkurrencës me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, kati IV. Nr.4.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë do të marrin informacion në faqen e Autoritetit të Konkurrencës për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Autoritetit të Konkurrencës duke filluar nga data **22 shtator 2021**.